



## ARSIMI I LARTË ME ÇDO ÇMIM?

Analiza e kostove dhe përfitimeve për studimet e disperzuara në Universitetin Shtetërorë në Republikën e Maqedonisë



## **Stërvitje:**

### **Autorë**

Mišo Dokmanović, Darko Spasevski, Katerina Shapkova  
Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim – ISIE

### **Mentorë**

Natasha Trajkova - Fakulteti ekonomik, Prilep

### **Përktheu**

Nevrije Shabani

### HYRJE

Qëllimi i këtij dokumenti është që me anë të analizës së kostove (angl. costs) dhe përfitimeve (angl. benefits) të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha avantazhet dhe dobësitë e politikës së zhvillimit të studimeve të disperzuara në universitetet shtetërore në Republikën e Maqedonisë, që të jepet një shqyrtim kritik i funksionimit dhe organizimit të tyre, si dhe për të përcaktuar konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e kësaj politike publike.

Në dekadën e fundit ky lloj studimesh në universitetet shtetërore u hap në 15 qytete dhe në to kanë studiuar më shumë se 15.000 studentë.

Që nga fillimi, zbatimi i studimeve të disperzuara lidhet me polemika dhe me kundërtënie në lidhje me efektet dhe qëndrueshmërinë e tyre. Qëndrimet varrojnë nga fakti se kjo politikë jep efekt, kontribuon në përmirësimin e përfshirjes së studentëve në arsimin e lartë, uljen e kostos për të studiuar dhe rritjen e mundësive për punësim, dhe deri te ajo se nuk i justifikon kostot, nuk lind nga nevoja faktike e tregut dhe është jo transparente.

Megjithatë, pavarësisht polemikave mbi këtë model studimi, kjo politikë publike rrallë bëhet objekt i debatit publik. Cilësia dhe mënyra e organizimit të studimeve të disperzuara në dekadën e fundit nuk ka qenë subjekt i analizave të sistemit, me përjashtim të një hulumtimi të segmentuar (Popovski, 2010). Përveç kësaj, një arsye shtesë dhe një sfidë kreative për zbatimin e këtij hulumtimi paraqet fakti se nuk ka të dhëna statistike në dispozicion nga institucionet kompetente shtetërore për parametrat themelore të këtij lloji të studimeve, si dhe efektet e kësaj politike publike nëpërmjet prizmit të kostove dhe përfitimeve.

Sipas përmbajtjes së tij, ky dokument targeton studentët, organizatat studentore, stafin akademik, fakultetet, universitetet, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), si dhe të gjithë aktorët e tjerë. Në kapitullin e parë të kësaj analize përfshihen prirjet dhe tiparet kryesore të zhvillimit të politikës në fjalë në arsimin e lartë, si dhe avantazhet dhe disavantazhet. Në kapitullin e dytë diskutohen kostot dhe përfitimet e studimeve të disperzuara përmes identifikimit dhe matjes së tyre me anë të analizës së kostove dhe përfitimeve. Në kapitullin e tretë paraqiten rezultatet e analizës, dhe në kapitullin e katërt të jepen konkluzat. Në fund renditet bibliografia dhe burimet e përdorura.

## FAKTE RRETH POLITIKËS DHE SITUATËS AKTUALE

### TRENDET NË ARSIMIN E LARTË

Zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë (RM) në dekadën e fundit e karakterizuan disa trende. Së pari, erdhi deri në një rritje të konsiderueshme të numrin të universiteteve, fakulteteve dhe programeve studimore në vend. Sipas Ministrisë së Arsimit, në vitin 2006 ka pasur tri universitete publike, në vitin 2016 - gjashtë (një në formën e partneritetit publik-privat), ndërsa në procedurë është krijimi edhe i dy universiteteve tjera publike.

Së dyti, u bë promovimi i politikës së zhvillimit dhe promovimit të studimeve të disperzuara të organizuara nga universitetet dhe fakultetet ekzistuese. Brenda vetëm disa viteve u hapën studime të disperzuara në 15 qytete. Së treti, si rezultat i këtyre tendencave erdhi deri te rritja e numrit te vendeve të lira në universitete, si dhe në numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar. Për ilustrim, sipas një studimi nga Qendra për hulumtime dhe krijim të politikave në vitin akademik 2008/09 në konkurset për regjistrim në universiteteve të reja janë hapur në mënyrë të konsiderueshme më shumë vende të lira sesa numri i maturantëve që e kanë kaluar provimin e maturës (Центар за истражување и креирање политики, 2009). Paralelisht me te, disa vite me radhë më shumë se 90 për qind e studentëve që kanë kaluar provimin e maturës janë regjistruar në universitet.

Këto procese kanë kontribuar në ndryshimin e dukshëm të kornizës brenda të cilës vepron arsimit i lartë në vend. Duke pasur parasysh këto trende të përgjithshme, analiza e kostove dhe përfitimeve (në tekstin e mëtejshëm: AKP) është përqendruar në studimet e disperzuara në tre universitetet publike të renditura sipas rangimit të fundit të publikuar sipas listës së Shangait: „Shën Kirili dhe Metodi „- Shkup (Universiteti i Shkupit), Universiteti“ Goce Dellçev „- Shtip (UGD) dhe“ Shën Kliment Ohridski „- Manastir (UKLO).<sup>1</sup>

### ZHVILLIMI I STUDIMEVE TË DISPERZUARA

Model i organizuar i studimeve të disperzuara këtë vit shënon dhjetë vjet që nga fillimi i programeve të para të studimit të disperzuar në vitin akademik 2005/06. Studimet e para të disperzuara në Maqedoni u organizuan në vitin akademik 2005/06 nga UKIM.<sup>2</sup> Në këtë vit akademik, UKIM, gjegjësisht katër njësi të tij filluan të mbajnë ligjërata në

1 Në kuadër të analizës kishte përpjekje për të përfshirë edhe Universitetin e Tetovës, i cili nuk u prononcua në lidhje me kërkesën për qasje të lirë në informata me karakter publik, ndërsa „Shën Apostoll Pavli „në Ohër nuk ka organizuar studime të disperzuara. Mbi kërkesën e paraqitur për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nuk është prononcuar as Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2 Si një përpjekje e parë për të organizuar studimet e disperzuara mund të konsiderohet organizimi i qendrës në Fakultetin Juridik të Shkupit në Manastir në vitin akademik 1970/71. Nga viti akademik 1970/71 në 1976/77, kur është themeluar Fakulteti i veçantë juridik në Manastir, kanë qenë të regjistruar 1.800 studentë. Fakulteti në Manastir pushoi së funksionuar në vitin 1987 me Ligjin për shfuqizim të Fakultetit Juridik në Manastir, i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSM numri 32/87 (Konevski, 2010).

## ARSIMI I LARTË ME ÇDO ÇMIM?

Shtip (Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Mjekësisë), dhe një njësi tjetër e tij në Strumicë (Fakulteti i Bujqësisë dhe Ushqimit).

Pritshmëria ishte që nëpërmjet studimeve të disperzuara do të ndikohet në tregun e punës duke rritur përfaqësimin e personave me arsim të lartë dhe në këtë mënyrë do të pengohet procesi i migrimit të brendshëm nga punësimi i të diplomuarve në tregun lokal të punës. Përveç kësaj, ky proces ka filluar me qëllim të parandalimit të ikjes së studentëve nëpër vendet fqinje dhe për të ulur kostot e studimit.

Gjatë krijimit të këtyre studimeve, duhet theksuar se një numër i konsiderueshëm i studentëve nga Maqedonia filluan të shfaqin interes për të studiuar në vendet fqinje.

**Tabela 1.** Numri i studentëve të regjistruar në studimet e disperzuara të UKIM (sipas fakulteteve dhe viteve akademike)

Fakultetet	2006/ 2007	2007/ 2008	2008/ 2009	2009/ 2010	2010/ 2011	2011/ 2012	2012/ 2013	2013/ 2014	2014/ 2015	2015/ 2016
Fakulteti i Ekonomisë	182			44	59	59	32	32	18	18
Fakulteti i drejtësisë	137		103	83	54	42	0	13	20	0
Fakulteti i mjekësisë	12									
Fakulteti i Bujqësisë dhe Ushqimit	51	0	12	62	28	3	0	12		
Fakulteti arkitektonik	0			0						
Fakulteti i Ndërtimtarisë	0			8	0	0	0			
Fakulteti Elektroteknik dhe i teknologjive informatike	59			11	1	0	1			
Fakulteti i Makinerisë				1						
Shkencat Natyrore dhe Matematika				51	2	0				
Teknologjia dhe Metalurgjia	0				26	25	13	2		
FINKI								1		
<b>TOTAL UKIM</b>	<b>441</b>	<b>0</b>	<b>115</b>	<b>260</b>	<b>170</b>	<b>129</b>	<b>46</b>	<b>60</b>	<b>38</b>	<b>18</b>

Burimi: Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi“ - Shkup

Domethënie të veçantë në zhvillimin e këtij lloji të studimeve kishte vendimi për themelimin e Universitetit „Goce Dellçev“ në Shtip, i cili që nga fillimi i tij në vitin 2007 që orientuar drejt zhvillimit të këtij lloji të studimit.

Qeveria e RM në kuadër të politikës së saj për sigurim të qasjes më të madhe në të drejtën për arsim të lartë, nga 2008/2009 vendosi që të rrisë numrin e programeve të studimit në studimet e disperzuara nëpër universitetet publike.

Shuma e kompensimit të këtyre studimeve, nga viti i parë i studimeve, caktohej nga ana e universiteteve publike dhe shkonte nga 200 deri në 250 euro për studentët e rregullt në kuotën shtetërore, dhe prej 400 deri në 800 euro për studentët në kuotën e ko-financimit, ndërsa nga viti 2010/2011, ajo përcaktohet nga Qeveria e RM-së dhe

arrin shumën e 100 euro-ve si për studentët në kuotën shtetërore ashtu edhe të atyre në kuotën me bashkëfinancim (Државен завод за ревизија, 2011). Siç do ta shohim në analizë, vendimi për të reduktuar koston e studimeve kishte ndikim edhe në vendimin e kandidatëve të mundshëm për zgjedhjen e studimit të këtij lloji.

**Tabela 2.** Numri i studentëve në studimet e disperzuara UKLO (sipas fakulteteve dhe viteve akademike)

Fakultet	2006/ 2007	2007/ 2008	2008/ 2009	2009/ 2010	2010/ 2011	2011/ 2012	2012/ 2013	2013/ 2014	2014/ 2015	2015/ 2016
Fakulteti teknik - Manastir	0	0	138	151	134	179	150	124	0	0
Fakulteti i Turizmit dhe hotelerisë - Ohër	0	0	173	195	137	143	41	39	0	25
Fakulteti Ekonomik - Prilep	0	0	0	0	0	0	6	0	0	0
Fakulteti Pedagogjik - Manastir	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fakulteti i Drejtësisë-Kërçovë	0	0	95	233	297	333	300	254	238	177
Fakulteti Teknik Teknologjik	0	0	39	36	124	107	70	96	95	63
Fakulteti i TIK - Manastir	0	0	0	0	0	0	0	0	95	54
<b>TOTAL UKLO</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>445</b>	<b>615</b>	<b>692</b>	<b>762</b>	<b>567</b>	<b>513</b>	<b>428</b>	<b>319</b>

Burimi: Universiteti „Shën. Kliment Ohridski“ - Manastir

Sipas raportit mbi aktivitetet e realizuara në sektorin e arsimit të lartë të Ministrisë së Arsimit për vitin 2010 në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2011 janë organizuar studime të disperzuara për 48 programe të ndryshme në katër universitete publike. Ato u zhvilluan në 15 qytete në Republikën e Maqedonisë, dhe atë: Kavadar, Kërçovë, Kriva Pallankë, Veles, Probishtip, Strumicë, Sveti Nikole, Strugë, Shkup, Gjevgjeli, Dibër, Berovë, Manastir, Shtip dhe Prilep. Vetë studimet e disperzuara janë kryer përmes ligjeratave dhe provimeve në qytetet jashtë selive të fakulteteve. Studimet janë kryer në objektet të llojeve të ndryshme si qendra kulturore, shtëpi të komunitetit rinor, shkolla të mesme, etj (UKIM dhe UKLO), por edhe në objektet të departamenteve tjera brenda të njëjtit Universitetit (UGD).

**Tabela 3.** Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në studimet e disperzuara në tre universitetet e para shtetërore

Universitet	2006/ 2007	2007/ 2008	2008/ 2009	2009/ 2010	2010/ 2011	2011/ 2012	2012/ 2013	2013/ 2014	2014/ 2015	2015/ 2016	total
UKIM	441	0	115	260	170	129	46	60	38	18	1277
UGD	0	38	458	965	1146	1348	1361	1217	1372	1083	8988
UKLO	0	0	445	615	692	762	567	513	428	319	4341
<b>Total i 3 universiteteve shtetërore</b>	<b>441</b>	<b>38</b>	<b>1018</b>	<b>1840</b>	<b>2008</b>	<b>2239</b>	<b>1974</b>	<b>1790</b>	<b>1838</b>	<b>1420</b>	<b>14606</b>


Burimi: Të dhënat e ofruara nga UKIM, UKLO dhe UGD, llogaritjet janë të autorëve.

Që nga viti shkollor 2006/07 deri në vitin 2015/16 vitit në tre universitetet e para publike janë regjistruar gjithsej 14,606 nxënës. Numri më i madh i studentëve në studime e disperzuara, apo 61.54 për qind i totalit të studentëve, kanë studiuar në UGD (gjithsej 8988 studentë), ndërsa numri më i vogël në UKIM (1.277) – ose 8.74 për qind i totalit. Analiza tregon se interesimi më i madh për regjistrim në këtë lloj të studimeve në nivel shtetëror kishte në vitin 2011/12 kur janë regjistruar 2,239, pas së cilës fillon një tendencë rënieje në interesin e studentëve me çka në vitin akademik 2015/16 të regjistrohen vetëm 1.420 studentë.

Interesi i ulët për këtë lloj të studimeve bie më së shumti në sy në universitetin më të madh dhe më të vjetër në vend, ku në 10 vitet e fundit janë regjistruar në total 1.277 studentë. Sipas të dhënave të publikuara në tabelën 1, interesimi më i lartë për regjistrim në këtë lloj të studimeve në UKIM ka ekzistuar në vitin akademik 2006/7 kur janë regjistruar 441 studentë, ndërsa në katër vitet e fundit numri i përgjithshëm i të regjistruarve shënohet me numra dy-shifrorë.

Sa i përket UKLO-së, sipas të dhënave të shënuara në Tabelën 2, interesimi më i madh për studim në studimet e disperzuara ka ekzistuar në vitin akademik 2011/12 (762 studentë të regjistruar), pas të cilit ka trend të dukshëm në rënie që rezulton në atë se në vitin 2015/16 është regjistruar numri më i vogël i studentëve nga të gjitha vitet e analizuarra (319 studentë). Për më tepër, është e qartë se tek një numër i madh i programeve të studimeve të disperzuara nuk ka pasur aspak interes në mesin e kandidatëve të mundshëm, siç edhe mund të shihet në tabelat 1 dhe 2. Të dhënat tregojnë se shpesh ka ndodhur që për ndonjë program studimor të caktuar të mos ketë aplikuar asnjë kandidat ose vetëm disa. Së fundi, numri më i madh i studentëve të regjistruar në UGD është shënuar në vitin akademik 2014/15 (1372 studentë), pas së cilit mund të vërejmë një rënie të interesit (në vitin akademik 2015/16 janë regjistruar 1.083 studentë).

**Figura 1.** Trendi në regjistrimin në studimet e disperzuara në vite akademike në tre universitetet e para shtetërore





## STUDIMET E DISPERZUARA SI POLITIKË PUBLIKE

Studimet e disperzuara janë realizuar në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë. Tendanca për mbështetjen dhe zhvillimin e studimeve të disperzuara në universitete publike në Maqedoni është e pranishme në shumë dokumente publike, përkatësisht dokumente për krijim të politikave.

Kahja për të organizuar studime të disperzuara si politikë publike formale është vërejtur në Strategjinë e zhvillimit rajonal të Republikës së Maqedonisë në periudhën 2009 - 2019 dhe Strategjisë për ndryshimin dhe plotësimin e strategjisë së zhvillim rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019. Përmes studimeve të disperzuara, në përputhshmëri me këto strategji duhej të arrihet reduktimi i shpërndarjes së pabarabartë të investimeve dhe punësimit nëpër rajone.

Përveç kësaj, në bazë të Strategjisë për barazinë gjinore në Republikën e Maqedonisë (2013-2020), ekzistenca e shumë institucioneve të arsimit të lartë, si shtetërore ashtu edhe private, mundësoi qasje më të lehtë dhe mundësi për zgjedhje më të madhe. Sipas këtij dokumenti, hapja e 46 programeve të studimit në 15 qytete duhej të mundësonte reduktim të kostove të studimit dhe përmirësimin e përfaqësimit të studenteve femra në institucionet e arsimit të lartë (Министерство за труд и социјална политика, 2013).

Interesi për zhvillimin e studimeve të disperzuara është i pranishëm edhe në njësitë e qeverisjes lokale. Në këtë drejtim, në kuadër të planit strategjik për komunat Radovish dhe Konçe (2007-2011) ishte vërtetuar nevoja e hapjes së studimeve të disperzuara në Radovish (Општини Радовиш и Конче, 2007). Përveç kësaj, shembull shumë ilustrues është ai i komunës së Kavadarit, e cili siguron ndihmë financiare për studentët që ndjekin studimet e disperzuara në këtë qytet.

Së fundi, orientimi për të promovuar këtë lloj studimi është i përfshirë edhe në kuadër të programeve të disa partive politike. Në programin politik të partisë në pushtet, VMRO-DPMNE, për zgjedhjet e vitit 2008 përfshihet qëndrimi mbi hapjen e fakulteteve të reja dhe studime të disperzuara (ВМРО-ДПМНЕ, 2008). Vetë politika publike demonstroi se ky pozicion nuk ka ndryshuar.

## AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E POLITIKËS

Në dekadën e fundit, kjo politikë në mënyrë të vazhdueshme ka qenë subjekt i kritikave, si pozitive ashtu dhe negative. Si rezultat i kësaj, në vend ekzistojnë mendime dhe qëndrime kundërshtuese mbi konceptin, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e këtij lloji të studimeve (Алон.мк 2014; Костовски, 2009). Paralelisht, duhet theksuar se në dekadën e fundit është kryer vetëm një studim kërkimorë i segmentuar mbi studimet e disperzuara (Поповски, 2010).

Mbështetësit dhe promovuesit e studimeve të disperzuara nxjerrin në pah argumentet se këto studime kryhen në vendin e banimit ose në afërsi të studentëve që çon në redu-



ktim të kostove të studimit; nxisin ekonominë lokale dhe zhvillimin; nëpërmjet rritjes së numrit të universiteteve, fakulteteve dhe programeve studimore rritet mundësia e zgjedhjes për studentët; studentët mbeten në mjediset e tyre dhe mundësitë e punësimit të tyre i kërkojnë nga punëdhënësit lokalë. Një argument tjetër që është përmendur shpesh është se me anë të politikës së hapjes së fakulteteve të reja dhe studimeve të disperzuara, përqindja e maturantëve që regjistrohen në studime shkon duke u rritur.

Në anën tjetër, kritikët e kësaj politike si sfida potenciale citojnë: (1) studimet e disperzuara shpesh hapen pa konsultim paraprak me fakultetet, pa monitorimin të mekanizmit të tregut dhe pa kornizë financiare (Хаџи-Зафирова, 2009) dhe përfaqësojnë një lloj ndërhyrjeje të intensifikuar të shtetit; (2) një pjesë e studimeve të disperzuara hapen në qytetet ku tashmë ekzistojnë studime të njëjta apo të ngjashme në universitetet shtetëror; (3) në rastet kur studimet realizohen në kushte të papërshtatshme, pa pajisje të duhura, bibliotekë apo laborator, cilësia e studimeve vihet në pikëpyetje; (4) në disa raste janë hasur probleme në financimin dhe transferimin e fondeve për realizimin e studimeve; dhe (5) inaugurimi i studimeve të disperzuara zvogëlon interesin për studimet e rregullta universitare (УКИМ, 2011).

## TKOSTOT DHE PËRFITIMET E STUDIMEVE TË DISPERZUARA NË UNIVERSITETET SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Njëra nga teknikat financiare që përdoret shpesh për shqyrtim të justifikimit për ndërmarrjen e një projekti të caktuar investues është analiza e kostove dhe përfitimeve (AKP). Kjo metodë konsiston në identifikimin e kostove që lidhen me një projekt të veçantë gjegjësisht me një politike të caktuar publike, pastaj matje të kostove të vërtetuara dhe krahasimi i tyre me përfitimet e pritshme të investimit.

Aplikimi i AKP në planifikimin arsimor nuk paraqet ndonjë risi (Mincer, 1974; Davarajan et al., 1994; Volfe and Zuvekas, 1997; Angist and Levy, 2002; Psacharopoulos and Patrinos, 2004; Perkins and Radelet, 2006). Përdorimi i AKP ofron një mundësi unike për një analizë objektive të investimeve në shumë sektorë, duke përfshirë këtu edhe arsimin. Një nga arsyt kryesore për popullaritetin e kësaj teknike është se me të reformat e arsimit trajtohen si projekt investues dhe për këtë arsye mund të japë përfundime të dobishme në lidhje me arsyetimin për investimin e fondeve publike në projekte të veçanta arsimore.

Ky hulumtim është përpjekja e parë për të bërë AKP mbi arsimin e lartë. Siç u tha më parë, publiku hulumtues deri më tani ka treguar interes për vlerësimin e rezultateve të arsimit të lartë në vend, por deri më tani nuk është bërë një studim i këtij lloji, i cili përdor mjetet e analizës financiare dhe e cila në mënyrë specifike i monetizon kostot

dhe përfitimet e arsimit të lartë. Gjatë përpilimit të AKP, potencojmë katër vendime që lidhen me aktivitetin e investimeve dhe të cilat i formojnë rezultatet e analizave: 1) identifikimi dhe monetizimi i kostove; 2) identifikimi dhe monetizimi i përfitimeve; 3) përcaktimi i normës së diskontuar; dhe 4) përcaktimi i horizontit kohor.

Para se të vazhdojmë në drejtim të shpjegimit të kostove dhe përfitimeve të zgjedhura, dëshirojmë të theksojmë se qëllimi i hulumtimit tonë nuk është shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme në arsimin e lartë, por sublimimi i efekteve të politikës së studimeve të disperzuara si risi dhe differentia specifika e hapësirës së arsimit të lartë në Maqedoni. Ky shënim fillestar ndikon në përzgjedhjen e përfitimeve dhe shpenzimeve që do të përfshihen në analizë. Gjegjesisht, gjatë përgatitjes së studimit u bënë përpjekje për të regjistruar vetëm të ardhurat dhe shpenzimet që janë karakteristikë e studimeve të disperzuara dhe të cilat ndryshojnë nga shpenzimet që kanë universitetet në studimet amë.

## MATJA E KOSTOVE

Në AKP, me kosto nënkuptohen kostot totale oportune të projektit investues, të cilat i përfaqësojnë alternativat e ndryshme që sakrifikohen për përdorimin e burimeve, ose për konsum apo për ndonjë formë tjetër të investimeve (Woodhal, 2004, стр. 29). Këto kosto ende njihen si „kostot reale të arsimit të lartë” (Dunn and Sullins, 1982, стр. 26).

AKP-ja standarde i klasifikon shpenzimet që merren në konsideratë si shpenzime materiale (të drejtpërdrejta) dhe jo materiale (të tërthorta). Kostot direkte paraqesin shpenzimet aktuale në universitete gjegjesisht fakultete. Llogaritja e tyre është relativisht e thjeshtë, duke pasur parasysh se shumica e këtyre shpenzimeve kanë një sasi të caktuar monetare. Për dallim prej tyre, llogaritja e shpenzimeve indirekte është dukshëm më e komplikuar, sepse nuk ka asnjë masë objektive për valorizimin dhe krahasimin e tyre. Ky grup përfshin mundësitë e humbura për përdorim alternativ të burimeve.

Përveç kësaj, në varësi të asaj se cili është subjekti që mbart barrën e shpenzimeve, shpenzimet në arsim ndahen në private dhe sociale. Shpenzimet private përdoren për të shpjeguar pranueshmërinë e investimit në aspekt të studentit ose eventualisht familjen e tij. Nëse qëllimi i AKP është të analizojë investimin nga pikëpamja sociale, përdorim shpenzimet e përgjithshme shoqërore të cilat do të duhet të raportojnë efektin total të investimeve në arsim për ekonominë.

Zakonisht, në AKP të fushës së arsimit të lartë, në grupin e kostove direkte përfshihen kostot e universiteteve për pagat dhe kontributet e punonjësve, kostot për shërbimet kontraktuese, prokurimi i pajisjeve, librat dhe materiale të tjera dhe kështu me radhë. Në këtë kategori detyrimisht regjistrohen edhe shpenzimet kapitale të universiteteve. Përfshirja e këtyre shpenzimeve konsiderohet gabim, sepse kështu arrihet deri te një nënvlerësim i shpenzimeve të përgjithshme. Shpenzimet kapitale në nivel vjetor paraqiten përmes shumës vjetore të amortizimit të mallrave kapitale (Dunn and Sullins, 1982) ose duke përfshirë koston vjetore të marrjes me qira të ambienteve (Woodhall,

## ARSIMI I LARTË ME ÇDO ÇMIM?

2004). Kostot direkte për studentët përfaqësojnë shpenzimet e tarifës shkollore, blerjen e librave, akomodimin, transportin dhe kështu me radhë.

Shpenzimet indirekte janë më të vështira për t'u kuantifikuar, ndryshe nga kostot direkte. Kosto indirekte klasike paraqesin të ardhurat që do të kishin realizuar studentët në qoftë se ata vendosin që të punojnë në vend që të studiojnë. Brenda këtij grupi, më e komplikuar është vlerësimi i kostove oportune të alternativave të humbura për investim.

Bazuar në klasifikimet e mëparshme në përcaktimin e kostos, për nevojat e AKP të studimeve të disperzuara i përcaktuam kostot themelore të paraqitura në Tabelën 4. Metodologjia për llogaritjen e kostove përdoret për të llogaritur shumën vjetore të shpenzimeve.

**Tabela 4.** Identifikimi i kostove në AKP për studimet e disperzuara

Lloji i kostove	Spjegim	Metodologjia për llogaritje	Burimet e të dhënave
<b>Kostot direkte të universiteteve</b>			
<b>Ditarët për stafin mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët</b>	Kostoja vjetore e ditarëve për të stafit mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët që marrin pjesë në procesin mësimor të studimeve të disperzuara	Mëditja mesatare x numri i ditëve të angazhimit	marrëveshja kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë
<b>Shpenzimet e transportit</b>	Shpenzimet totale vjetore për transport prej dhe deri te vendi ku zhvillohet procesi mësimor i studimeve të disperzuara	Distanca e studimeve të disperzuara X Çmimi mesatar me pakicë i benzinës x 0,3 (standard i kontabilitetit)	Llogaritja e autorëve Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë Raportet vjetore për punën e Komisionit rregullator për energjetikë
<b>Qiraja</b>	Shpenzimet totale vjetore të qirasë së hapësirës në të cilën zhvillohet mësimi	Numri i nxënësve x hapësira e nevojshme neto për student x çmimi mesatar i tregut për m <sup>2</sup>	Informata të karakterit publik të marra nga universitetet (numri i studentëve) Dekreti për normat dhe standardet për themelimin të institucioneve të arsimit të lartë dhe për zhvillimin të veprimtarisë së arsimit të lartë
<b>Shpenzimet e tarifës studimore</b>	Kostot totale vjetore të tarifës studimore	Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik x tarifa studimore	Informata të karakterit publik të marra nga universitetet (numri i studentëve dhe tarifa studimore)
<b>Shpenzimet komunale</b>	Shpenzimet e rrymës elektrike, ngrohjes, ujit dhe shpenzime tjera komunale.		

<b>Kostot direkte private</b>			
<b>Transporti i studentëve</b>	Kostoja mesatare vjetore e studentëve të studimeve të disperzuara për transport deri në universitet	Vlera mesatare e kostos së transportit të marra nga një sondazh i studentëve x Numri i nxënësve	Anketa e kryer me studentë të studimeve të disperzuara (për shpenzimet e transportit) Informata të karakterit publik të marra nga universitetet (numri i studentëve)
<b>Shpenzimet e akomodimit të studentëve</b>	Kostoja mesatare vjetore e studentëve nga studimet e disperzuara për vendosje në vendet ku ndjekin ligjërata	Vlera mesatare e kostos së akomodimit të marra nga një sondazh i studentëve x Numri i nxënësve	Anketa e kryer me studentë të studimeve të disperzuara (për shpenzimet e qirasë) Informata të karakterit publik të marra nga universitetet (numri i studentëve)
<b>Shpenzimet për literaturë dhe materiale</b>	Kostoja mesatare vjetore e studentëve nga studimet e disperzuara për literaturë dhe materiale	Vlera mesatare e kostos së literaturës dhe materialeve të marra nga një sondazh i studentëve x Numri i nxënësve	Anketa e kryer me studentë të studimeve të disperzuara (për shpenzimet të literaturës dhe materialeve) Informata të karakterit publik të marra nga universitetet (numri i studentëve)
<b>Kostot indirekte</b>			
<b>Përfitimi i humbur i studentëve</b>	Kostoja oportune e studimit e matur në pagë që do t'a kishin realizuar studentët nëse në vend të studimeve do të zgjidhnin të punonin (e korrigjuar sipas normën e papunësisë)	Rroga mesatare vjetore bruto e njerëzve me nivel të mesëm të arsimit x Numri i studentëve x (1 - shkalla e papunësisë)	Enti shtetëror i statistikës Informata të karakterit publik të marra nga universitetet (numri i studentëve)

Gjatë përzgjedhjes së shpenzimeve që do të përfshihen në analizë, udhëhiqeshim nga dy parime. Së pari, u vendos që përzgjedhja e shpenzimeve në këtë analizë, të mos devijojë nga klasifikimi i kostove në AKP të standardizuar që aplikohet në arsimin e lartë. Së dyti, duke pasur parasysh se qëllimi i hulumtimit është që të shqyrtojë efektet e studimeve të disperzuara, dhe jo të vlerësojë arsimin e lartë në tërësi, gjatë përzgjedhjes së shpenzimeve kishim kujdes të përfshijmë vetëm ato shpenzime që rezultojnë drejtpërdrejt ose që kanë lidhje me funksionimin e këtyre studime. Kështu, ato kosto direkte dhe indirekte të cilat janë specifike për arsimin e lartë, dhe të cilat do të shfaqeshin pa marrë parasysh nëse një pjesë e programeve studimore disperzohen, u përjashtuan nga analiza. Një shembull i kostove të tilla janë shpenzimet që kanë institucionet e arsimit të lartë për të siguruar biblioteka, fondin e librit dhe kështu me radhë. Nga kjo mund të konstatojmë se kjo analizë shqyrton ndikimin marginal që kanë studimet e disperzuara mbi arsimin e lartë.

### IDENTIFIKIMI I PËRFITIMEVE

Vlerësimi i përfitimeve të projekteve të arsimit të lartë bëhet përmes pjesëmarrjes së arsimit, gjegjësisht të arsimit të lartë në krijimin e niveleve të ardhshme të të ardhurave apo konsumit.

*„Mënyra e qartë me të cilën arsimi kontribuon në të ardhurat e së ardhmes është duke përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e forcës punëtore të arsimuar, domethënë nga produktiviteti i punës. Në qoftë se produktiviteti i punëtorëve të arsimuar është më i lartë se ajo e të paarsimuarve, kjo do të reflektohet në rritjen e rezultateve dhe në të ardhurat më të larta të të arsimuarve. Prandaj, ne kemi nevojë për një vlerësim të të ardhurave shtesë gjatë jetës së punëtorëve të arsimuar.” (Woodhall, 2004)*

Përfitimet kryesore që krijohen nga arsimi i lartë, dhe në këtë kuptim edhe nga studimet e disperzuara, do të prezantohen përmes mundësisë që personave me arsim të lartë të realizojnë të ardhura më të larta në të ardhmen, në krahasim me njerëzit me arsim të ulët. Dallimet në të ardhurat, të matura si diferenca e pagave që realizojnë këto dy kategori të popullatës, janë baza për llogaritjen e përfitimeve të drejtpërdrejta. Ky ndryshim në disa studime quhet edhe „premium për diplomim” (ang. Graduate premium) (Eoodhall, 2004).

Por, këtu ka një dilemë thelbësore, dhe kjo është nëse diferenca në pagë midis atyre që kanë përfunduar arsimin e lartë dhe ata me arsim të mesëm ka të bëjë ekskluzivisht me arsim, apo ka edhe faktorë të tjerë që mund të shpjegojnë diferencialin në paga. Në këtë grup faktorësh përfshihen aftësitë natyrore të personit, motivimi, gjinia, profesioni, arsimi jo-formal dhe kështu me radhë. (Woodhall, 2004). Do të ishte gabim të supozohet se diferenca në pagë është vetëm për shkak të ndryshimit në arsim.

Në AKP, ky problem është tejkaluar në mënyrë që diferenciali në pagë shumëzohet me të ashtuquajturin „koeficienti  $\alpha$ ”, që paraqet pjesën e diferencës në paga për shkak të edukimit. Koeficienti  $\alpha$  është i njohur edhe si „rregullimi i aftësive” (eng: ability adjustment). Shumë kalkulime të normave të kthimit në arsim nisen nga diferencalet e pagave si shuma e përfitimeve të drejtpërdrejta me koeficientin e aftësive rregulluese të shumës  $\alpha=0,66$ . (Woodhall, 2004).

Kategoria e dytë e lidhur me përfitime të rëndësishme që krijon arsimi i lartë janë përfitime direkte private jo tregtare. Në këtë grup regjistrohen fitimet që rezultojnë nga përdorimi i kapitalit njerëzor brenda orëve jo-pune gjatë ditës (McMahon, 2006). Përfitimet jo tregtare janë paraqitur përmes: produktivitetit infra familjar, mundësia e zhvillimit kognitiv, efikasiteti i konsumit, efektet mbi shëndetin, planifikimi familjar dhe të tjerë. (Wolfe and Haveman, 2002).

Identifikimi dhe matja e përfitimeve nga ky grup karakterizohet me pengesa serioze metodologjike dhe kufizime pasi që natyra abstrakte e përfitimeve në këtë grup krijon probleme të mëdha në përcaktimin dhe matjen e tyre. Në rastin e analizës së studimeve të disperzuara problemi është edhe më e theksuar për shkak se numri i studentëve

që studiojnë në këto programe është shumë i vogël (në krahasim me popullsinë e përgjithshme studentore në vend), e cila edhe më tej komplikon shprehjen e tyre duke pasur parasysh se ndikimi i tyre social është pothuajse i parëndësishëm. Megjithatë, AKP nuk do të ishte objektive në qoftë se nuk trajtohen këto shpenzime. Në këtë drejtim, ne i referohemi një studimi që shpjegon se vlerat e përfitimeve jo-tregtare janë të rëndësishme dhe përfaqësojnë 80 për qind të shumës së kontributeve monetare financiare (McMahon, 2004).

Grupi i tretë i përfitimeve që kanë të bëjnë me arsimin përbëhet nga përfitimet sociale. Ata përfaqësohen nga përfitimet shitesë për shoqërinë mbi ata që ushtrojnë përfituesit e drejtpërdrejtë të arsimit të lartë (Dunn & Sullins, 1982). Ky grup përfshin: ndryshimin teknologjik, kohezionin social, reduktimi i krimit dhe të tjerët. (Wolfe and Haveman, 2002). Vlera e eksterne sociale është rreth 37 për qind e shumës së përgjithshme të kontributeve jo tregtare të arsimit (McMahon, 2006).

Në tabelën 5 janë dhënë përfitimet që përdoren në AKP të studimeve të disperzuara në universitetet shtetërore në Maqedoni.

**Tabela 5.** Identifikimi i përfitimeve në ATP të studimeve të disperzuara

Lloji i përfitimeve	Spjegim	Metodologjia e llogaritjes	Burimi i të dhënave
<b>Përfitimet direkte</b>			
<b>Dallimet në paga në mes të diplomuarve dhe atyre me arsim të mesëm</b>	Shuma totale vjetore e diferencës midis pagës së të diplomuarve dhe të personave me arsim të mesëm (e përshtatura për normë të papunësisë dhe të aftësive të përshtatura koeficienti $\alpha$ )	Të ardhurat mesatare vjetore bruto të personave me arsim të lartë * Numri i të diplomuarve (përshtatur për normë të papunësisë dhe $\alpha=0,66$ )	Enti shtetëror i statistikës Informata të karakterit publik të marra nga universitetet (numri i studentëve)
<b>Përfitimet private jotregtare</b>	Shuma totale vjetore e përfitimeve të vlerësuara jo tregtare private e studimeve të disperzuara	80 për qind i vlerës së përfitimeve të drejtpërdrejta tregtare	(McMahon, 2006)
<b>Përfitimet indirekte</b>			
<b>Përfitimet sociale (eksternalitet)</b>	Shuma totale vjetore e vlerësuar e përfitimeve më të gjera sociale të studimeve të disperzuara	37 për qind i vlerës së përfitimeve jo tregtare	(McMahon, 2004).

## IDENTIFIKIMI I NORMËS SË DISKONTIMIT

Zgjedhja e normës së diskontimit që do të përdoret në analizë është njëra nga dytërat më të ndërlikuara në përgatitjen e analizës së kostove dhe përfitimeve. Arsyeja për këtë është se në literaturë ekzistojnë më shumë qasje (në të shumtën e rasteve

konkurrenca) për përzgjedhjen e normës së diskontimit. Në hulumtimet në fushën e analizës së kostove dhe përfitimeve përdoren normat e mëposhtme të interesit: normat tregtare të interesit, produktiviteti marginal i investimeve, norma e diskontimit të korporatave, norma e huamarrjes së qeverisë, norma „personale” e diskontimit, norma „personale” shoqërore e diskontimit, norma e diskontimit të Pigu-së, kostoja oportune e kapitalit social (Dunn and Sullins,1982).

Llogaritja e vlerës aktuale të investimeve në hapjen e studimeve të reja të disperzuara dhe financimin e atyre ekzistuese është bërë duke përdorur një normë skontimi prej 8.9 për qind. Kjo rrjedh si shuma e normës së interesit të obligacioneve shtetërore dhjetë-vjeçare të Republikës së Maqedonisë në ankandin e Bankës Kombëtare të Maqedonisë të mbajtur më 22 dhjetor 2015, që është 3.5 për qind dhe premiumi për rrezikun e vendit në bazë të analizave të universiteti të New York-ut, „Shkolla e biznesit Stern”, e cila në dhjetor të vitit 2015 ishte 5.4 për qind.

## IDENTIFIKIMI PERIUdhË

Në mënyrë që të kuantifikojmë ndikimin që studimet e disperzuara kanë në arsimin e lartë nisemi nga ideja se duam që të shqyrtojmë efektin e zgjidhjeve aktuale. Andaj, këtu është vendosur që të nisemi nga supozimi se studimet e disperzuara datojnë nga viti akademik 2008/2009, kur për herë të parë kjo politikë ishte nisur në mënyrë të organizuar, ndërsa supozojmë se viti i fundit në të cilin bëhet regjistrimi është viti 2015/2016. Shpjegimi për këtë kufizim të afatit kohor për të cilin bëhet analiza është logjik. Qëllimi i analizës sonë është që të shqyrtojë arsyeshmërinë e kësaj politike duke vlerësuar rezultatet që kanë dalë nga studimet e disperzuara në të kaluarën dhe ato që pritet të ndjehen në të ardhmen.

Edhe pse analiza statistikore ofron zgjidhje të ndryshme për të supozuar numrin e nxënësve që do të regjistroheshin në studimet e disperzuara në të ardhmen (p.sh. ekstrapolacioni i trendit, përdorimi i proceseve lëvizëse, etj), përsëri u vlerësua se është më e rëndësishme të bëhet një prerje e politikës së tanishme, dhe në bazë të rezultateve të fituara të ofrohen zgjidhje objektive dhe të qëndrueshme për justifikimin e përdorimit dhe forma së kësaj politike në të ardhmen.

Duke u nisur nga ky supozim, u vendos që kostot në AKP të evidentohen për periudhën 2008 - 2018, kur edhe pritet të diplomojnë studentët e fundit të fakulteteve që kanë programe të disperzuara. Nga ana tjetër, përfitimet te projektet në fushën e arsimit janë projektuar zakonisht për një periudhë më të gjatë, duke qenë se përfitimet e arsimit janë të lidhura direkt me punësimin dhe realizimin e të ardhurave pas diplomimit. (Woodhall, 2004). Këtu supozojmë se të diplomuarit e studimeve të disperzuara realizojnë fitime totale në periudhën e 35 viteve të ardhshme duke filluar nga viti i diplomimit. Kjo analizë deri në një masë është optimiste sepse supozojmë se njerëzit janë punësuar menjëherë pas diplomimit. Për fund, AKP është hartuar për periudhën 2008-2052<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Viti 2008 është viti zero.



## BURIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat e përdorura në analizë janë marrë nga disa burime të ndryshme:

- Përdorimi i qasjes së lirë në informatat me karakter publik - më 5 janar 2016 u dërguan kërkesa për qasje të lirë në informacione me karakter publik të mbajtësit e informacionit për çmimin e studimeve të disperzuara – deri te universitetet shtetërore dhe Ministria e arsimit dhe shkencës. Ky instrument mundësoi marrje te pjesshme të informatave shkaku i heshtjes së administratës. Andaj, pyetjes së vetme të cilës iu përgjigjën plotësisht ishte pyetja që i referohet numrit të studentëve të regjistruar në studimet e disperzuara. Në lidhje me kostot dhe përfitimet nga këto studime, një përgjigje e plotë është dorëzuar nga Fakulteti i teknologjive të informacionit dhe komunikimit në kuadër UKLO, ndërsa përgjigje të pjesshme u morën nga UGD. Universitetet tjera dhe Ministria e arsimit nuk iu përgjigjen kërkesave të parashtruara për informacion me interes publik.
- Në periudhën 5-31 janari 2016, u krye një anketë me studentë të mëparshëm dhe të tanishëm të studimeve të disperzuara - qëllimi i anketës ishte për të mbledhur informacione në lidhje me cilësinë, kostot dhe përfitimet nga studime gjeografikisht të disperzuara në vend. Pyetjet u organizuan në pesë grupe, dhe u referohen: 1) Profili arsimor dhe zgjedhja e programeve studimore; (2) shpenzimet me të cilat studentët përballen gjatë studimeve; (3) Përfitimet e studimit në studimet të disperzuara; (4) identifikimin e potencialeve të mundshme të studentëve për migrim (5) vlerësimin të cilësisë së studimeve të disperzuara. Sondazhi ka përfshirë 143 të anketuar, ose një për qind i numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në studimet e disperzuara. Në përzgjedhjen e të anketuarve u ruajt raportit proporcional në mes të numrit të studentëve të regjistruar në një universitet të caktuar dhe numri i përgjithshëm i studentëve në këtë lloj të studimeve. Të dhënat e mbledhura janë përdorur për të përcaktuar kostot dhe përfitimet që lidhen me studentët në kuadër të analizës.
- Disa nga të dhënat që përdoren në analizë ishin të dhëna dytësore të publikuara nga Enti shtetëror i statistikës (të dhënat për pagën mesatare vjetore bruto e paguar për punëtor, norma e papunësisë, numri i të diplomuarve dhe i studentëve të regjistruar në universitetet shtetërore).
- Kostot e transportit të kuadrit mësimdhënës në relacion nga selia e fakultetit deri te vendi ku organizohen studimet e disperzuara për një pjesë të fakulteteve janë siguruar nga përgjigjet që kemi marrë me kërkesën për qasje të lirë në informacion, dhe për ato fakultete që nuk kanë dhënë një përgjigje për këtë çështje, të dhënat janë marrë nga sistemi i prokurimit publik të Byrosë së prokurimit publik ndërsa një pjesë është llogaritur në bazë të metodologjisë për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit për udhëtime brenda vendit e përcaktuar nga marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik në Republikën e Maqedonisë (Gazeta zyrtare e RM nr. 10/2008 и 88/2008). Çmimet e karburantit janë vendosur në bazë të çmimit mesatar vjetor të shitjes me pakicë të benzinës Super 98 mb që burojnë nga raportet vjetore të Komisionit rregullator për energjetikë.

- Llogaritja e qirasë në fakultetet që organizojnë studime të disperzuara, dhe të cilat nuk iu përgjigjen kërkesës për qasje të lirë deri te informatat për çështjen e shpenzimeve në lidhje me qiratë është kryer si në vijim: numri i studentëve të regjistruar është shumëzuar me hapësirën neto që kërkohet për kokë studenti<sup>4</sup> në përputhje me Dekretin për norma dhe standarde për krijimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për zhvillim të veprimtarisë arsimore të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 103/2010) shumëzuar me çmimin mesatar për metër katror të hapësirës për dhënie me qira nga të dhëna të marra nga Agjencia për kadastrë të pasurive të patundshme të Republikës së Maqedonisë përmes sistemit Ages.
- Kostoja e ditarëve të kuadrit arsimor është llogaritur në përputhje me rregullat e vendosura nga Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë e që kanë të bëjnë me pagesën e mëditjeve për udhëtime në vend.

## REZULTATET E ANALIZËS

Duke marrë parasysh specifikat e secilit universitet në organizimin e studimeve të disperzuara, aspektin e programeve të studimit që ofrohen, shpërndarjen gjeografike, numrin e studentëve të regjistruar, kohëzgjatjen e studimeve, etj, vlerësuam se vlerësimi agregat i kostove dhe përfitimeve të kësaj politike për sa u përket të gjitha universiteteve shtetërore mund të çojë në krijimin e një imazhi të pasaktë të suksesit të politikës. Prandaj, janë hartuar tre analiza të veçanta që vlerësojnë veçmas pasojat më të gjera nga inaugurimi i studimeve të disperzuara në Universitetin „Shën Kirili dhe Metodi“- Shkup, Universiteti“ Shën Kliment Ohridski“- Manastir dhe Universiteti Shtetëror“ Goce Dellçev“- Shtip. Universiteti shtetëror i Tetovës është përjashtuar nga analiza për arsyen e thjeshtë se nuk kishte asnjë mundësi për të marrë të dhënat e nevojshme (universiteti nuk iu përgjigj kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, ndërsa në faqen e internetit dhe media të tjera nuk janë publikuar aspak të dhëna për zbatimin e studimeve të disperzuara).

Para se të kalojmë në interpretimin e rezultateve të hulumtimit, duam të japim disa vërejtje thelbësore për llogaritjen e kostove dhe përfitimeve.

Për shkak se shumë pak të dhëna në lidhje me kostot janë fituar përmes përgjigjeve nga kërkesat për qasje të lirë në informacione me karakter publik, në aspektin e kostos për qiratë, transportin dhe mëditjet e kuadrit arsimor janë përdorur burime shtesë. Gjegjesisht, u përdor dekreti për normat dhe standardet për krijimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për kryerjen e veprimtarisë arsimore të nivelit të lartë dhe Marrë-

<sup>4</sup> Hapësira e nevojshme neto për student shkon deri në - 3,5 m<sup>2</sup> për programet e studimit në fushën e shkencave shoqërore; - 4,5 m<sup>2</sup> për programet e studimit në fushën e shkencave natyrore dhe humane; - 7,5 m<sup>2</sup> për programet e studimit në fushat e shkencave teknike dhe bioteknike dhe - 8,5 m<sup>2</sup> për programet e studimit në fushën e shkencave mjekësore.

veshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik. Gjithashtu, janë përdorur edhe të dhënat publikisht në dispozicion nga Zyra e prokurimit publik të Republikës së Maqedonisë, Agjencisë për Kadastër të Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë.

Në llogaritjen e shpenzimeve private janë përdorur të dhënat nga anketa e studentëve. Pas përpunimit të të dhënave është llogaritur edhe vlerat që kanë të bëjnë me shpenzimet e studentit për transportin deri në vendin e studimit dhe ato të literaturës. Produkti i këtyre vlerave të medianës me numrin e studentëve në studimet e disperzuara paraqet koston totale private (kosto për studentët) për transportin dhe blerjen e literaturës. Për më tepër, shuma e përgjithshme e tarifës së studimit është llogaritur nga numri i përgjithshëm i nxënësve (informacion i marrë nga universitetet) e shumëzuar me participimin vjetorë për studim. Këtu supozojmë se shuma e participimit për student është 100 euro, ose 6.150 denarë (kursi i mesëm i Bankës Qendrore në vitin 2008).

Të ardhurat e humbura përfaqësojnë koston oportune të studentëve që studiojnë në studimet e disperzuara. Kjo kategori është llogaritur nga numri i përgjithshëm i studentëve<sup>5</sup>, shumëzuar nga paga që do të kishte realizuar në tregun e punës me arsim të mesëm. Pasi që Enti shtetëror për statistikë nuk publikon të dhëna vjetore mbi pagën bruto gjegjësisht të ardhurat bruto të personave me arsim të mesëm (trevjeçarë ose katërvjeçarë) si të ardhurat e humbura për student kemi përdorur pagën mesatare, të reduktuar me 12 për qind, aq sa përbën diferencën në të ardhurat bruto në mesin e njerëzve me arsim të mesëm dhe të lartë, në përputhshmëri me Entin shtetëror për statistikë për këto kategori të popullsisë në vitin 2010 dhe 2014. Shuma e llogaritur kështu është reduktuar nga shuma e shkallës së papunësisë në këtë kategori moshe. Në këtë rast kemi punuar me normën e papunësisë të publikuar nga Enti shtetëror për statistikë për personat e moshës 19-24 vjet, e cila është më e afërt me strukturën e moshës së personave që studiojnë në universitete. Nevoja për korigjim të tillë është për shkak të faktit se jo çdo njeri që është duke studiuar përballet me një kosto oportune, e matur nga të ardhurat e humbura. Domethënë, personat që nuk mund të punësohen nëse nuk kanë studiuar nuk kanë të ardhura të humbura (Dunn & Sullins, 1982).

Dallimi në paga që i realizojnë studentët e diplomuar ose që do të realizojnë në të ardhmen, në raport me personat me arsim të mesëm është regjistruar si një përfitim nga politika e studimeve të disperzuara. Shuma e përgjithshme e diferencialeve në paga në nivel vjetor është llogaritur si diferencë mesatare midis pagës së njerëzve me arsim të lartë dhe atyre me arsim të mesëm. Ky ndryshim është llogaritur në bazë të raporteve të ndryshimeve në të ardhurat bruto të publikuara nga Enti shtetëror për statistikë për vitin 2010 dhe 2014, nga e cila rrjedh se personat me arsim të mesëm realizojnë 88 për qind të të ardhurave të atyre me arsim të lartë. Prej këtu, në mungesë të të dhënave zyrtare vjetore mbi shumën e pagës bruto ose neto të personave me profil të ndryshëm arsimor ishte supozuar se diferencën e pagave është 12 për qind e pagës mesatare në favor të personave me arsim të lartë. Duke pasur parasysh se norma e papunësisë në Republikën e Maqedonisë është relativisht e lartë, supozuam se kjo do të ketë ndikim

5 Supozojmë se numri i studentëve të cilët braktisin studimet është i barabartë me 0 (zero).

në përfitimet nga arsimi, kështu që shuma e mëparshme ishte e korigjuar për normën e papunësisë në mesin e njerëzve të moshës 25 deri në 29 vjeç në vend <sup>6</sup>. Për më tepër, supozojmë se norma e diplomimit<sup>7</sup> është 50 për qind.

Kostot totale private jo tregtare janë vlerësuar si 80 për qindëshi i shumës së përgjithshme vjetore të dallimeve të pagave, ndërkohë që përfitimet sociale janë vlerësuar të arrijnë në 37 për qind të vlerës së shpenzimeve private jo tregtare.

Tabela në vijim paraqet koston totale të studimeve të disperzuara, përfitimet e përgjithshme dhe kostot neto në variantin e padiskontuar dhe vlerat përkatëse të vlerës neto aktuale dhe normës së brendshme të kontribuimit të projektit për secilin nga tre universitetet e përzgjedhura publike. Llogaritjet e detajuara për secilin nga universitetet janë të bashkangjitura veç e veç në këtë dokument.

**Tabela 6.**

Rezultatet e përmbledhura nga AKP në universitetet shtetërore në Maqedoni (në denarë).

Universiteti	Kostot totale (të padiskontuara)	Përfitimet totale (të padiskontuara)	Kostot neto (kostot totale të padiskontuara -përfitimet totale)	Vlera aktuale neto (NPV)
Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi"- Shkup, dhe	531.036.552	1.116.110.072	585.073.520	-220.053.744
Universiteti "Shën Kliment Ohridski"- Manastir	2.789.550.672	3.030.283.386	240.732.714	-1.473.418.669
Universiteti Shtetëror "Goce Dellçev"- Shtip	4.543.190.150	7.810.502.059	3.267.311.909	-1.828.831.899

Burimi: llogaritjet e autorëve

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, vlera aktuale neto e investimeve në studimet e disperzuara në tre universitete të përzgjedhura shtetërore është një vlerë negative. Ky rezultat është një sinjal i qartë se vlera sociale e kësaj forme të arsimit është e shtrenjtë dhe krijon më shumë shpenzime se përfitime. Studimet e disperzuara në Universitetin „Goce Dellçev” në Shtip kanë vlerën aktuale neto më të ulët, ndërsa UKIM më të madhe. Kjo nuk duhet të jetë e habitshme, duke pasur parasysh faktin se UGD ka regjistrim më të madh të studentëve ndërsa UKIM më të vogël. Në përputhje me rezultatet e arritura përmes përdorimit të këtij kriteri investues, rekomandojmë që projekti investues nuk duhet të pranohet apo, në këtë rast, të konsiderohet një riorganizimi serioz dhe efektiviteti i kostove dhe përfitimeve nga studimet e disperzuara apo, eventalisht, braktisjen e këtij koncepti.

<sup>6</sup> Në mungesë të parashikimeve zyrtare të lëvizjes së normës së papunësisë në të ardhmen, është supozuar se ajo do të rritet në mënyrë lineare bazuar në trendin në të kaluarën.

<sup>7</sup> E përllogaritur si raporti mes numrit të të diplomuarve në vitin aktual dhe numri i nxënësve të regjistruar para 3 ose 4 vjet (në varësi të kohëzgjatjes së programit të studimit).

Këtu dëshirojmë të theksojmë disa pika të rëndësishme që lidhen me procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave për shkak se ata kanë një ndikim të madh mbi rezultatet.

- Analizat e bëra, në mungesë të statistikave zyrtare për numrin e studentëve të diplomuar në studimet e disperzuara janë bërë me supozimin se norma e diplomimit është 50 për qind.
- Si një nga problemet më serioze të hasura në këtë analizë ishte fakti se nuk morrëm përgjigje të plotë lidhur me kërkesën për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Përgjigjet që mungojnë ishin të lidhura me të dhënat për shpenzimet për qira, transport si dhe pagat dhe kontributet e stafit mësimdhënës. Për këto arsye kemi përdorur burime të tjera për llogaritjen e kostove.
- Një nga dobësitë më serioze të kësaj analize është se ajo nuk është në gjendje për të mbuluar pasojat e shumta të studimeve të disperzuara që janë të natyrës kualitative. Ndër të tjera, kjo është kritika kryesore e analizës së kostove dhe përfitimeve të arsimit të lartë.
- AKP ndoshta nuk është zgjidhja më e përshtatshme për të analizuar efektet e inaurimit të studimeve të disperzuara. Në literaturë ekzistojnë mjete të tjera të cilët do të kishin paraqitur një situatë më realiste në këtë sektor (analiza e kostove dhe efektueshmërisë apo analiza e ndikimit).

Në bazë të studimit të bërë dhe rezultateve të arritura, mund të jepem **rekomandimet** në vijim:

- politika publike për zhvillim dhe promovim të studimeve të disperzuara duhet të rivlerësohet dhe të jetë subjekt i reformave urgjente në drejtim të racionalizimit të shpenzimeve lidhur me këto programe të studimeve;
- Procesi i rivlerësimit domosdoshmërisht duhet të përfshijë të gjitha palët e interesuara (universitetet, organizatat studentore, pushtetin vendor, komunitetin e biznesit, etj).
- shpenzimet e politikës duhet të qartësohen publikisht;
- një pjesë e studimeve të disperzuara duhet të pushojnë së funksionuar;
- duhet të përpilohet një metodologji dhe të caktohen standard për organizim të studimeve të disperzuara;
- kjo politikë publike duhet ta ketë parasysh distancën gjeografike në mes të dy programeve të njëjta të të njëjtit fakultet (për shembull, fakulteti i makinerisë nga Vinica, sipas konkursit për regjistrim të studentëve të rinj në vitin akademik 2015/16, disperson programin studimor në Koçanë, qytet në distancë prej vetëm 12 kilometrave);
- politika publike duhet ta ketë parasysh numrin e banorëve në një rajon të caktuar ose qytet gjatë përcaktimit të numrit të drejtimeve në programet e studimeve të disperzuara;
- duhet të kufizohet përsëritja e të njëjtave programe studimore nga fakultete të ndryshme ose universitete në të njëjtin qytet, dhe
- duhet të stimulohet ndërtimi dhe zhvillimi i qendrave universitare në gravitim dhe ndërtimi i infrastrukturës universitare adekuate.

## PËRFUNDIM

AKP-ja e kryer ka konstatuar se ekziston një numër i madh i sfidave që kanë të bëjnë me organizimin dhe zhvillimin e studimeve të disperzuara në universitetet shtetërore në të ardhmen. Studimet e disperzuara në formën e tyre të tanishme nuk janë të qëndrueshme kryesisht për shkak të kostos së lartë. Në këtë drejtim, rivlerësimi i tyre përmes një procesi të hapur dhe transparent që përfshin të gjitha grupet e interesit duhet të shihet si prioritet.

Investimi në potencialin e kërkimit shkencor të institucioneve të arsimit të lartë ka domethënie thelbësore për zhvillimin e arsimit. Për këto arsye, përcaktimi i qartë i kostove dhe përfitimeve është parakusht thelbësor për politika të suksesshme publike. Në këtë aspekt, ky dokument ofroi rekomandime për arritjen e optimumit në këtë lloj të studimeve gjithnjë në bazë të rezultateve të analizës.

Përfundimisht, duhet theksuar se disa aspekte të cilësisë së studimeve nuk mund të përcaktohen plotësisht përmes AKP-së dhe si rezultat i kësaj, paraqesin një sfidë tjetër në dhënien e një pasqyre të plotë të situatës dhe potencialin e studimeve të disperzuara në universitetet shtetërore në vend.

## BIBLIOGRAFIA

- [1] Angrist, J. and V. Lavy. (2002). New Evidence on Classroom Computers and Pupil Learning. ВМРО – ДПМНЕ (2008) *Програма на ВМРО – ДПМНЕ за илтерогба*.
- [2] Државен завод за ревизија (2011) *Ревизорски наог – Финансирање на високошко образование*.
- [3] Коевски, Г. (2010) *Правен факултет „Јусџинијан Први“, историски развој 1962-2005*. Книга II, Скопје, Правен факултет.
- [4] Костовски, Љ. (2009) Факултети што паѓаат на колоквиум. *Магазин Глобус*, 18 декември 2009. [на интернет] Достапно на: <http://www.globusmagazin.com.mk/?ltemID=6C2BBCD75A47634793723E18D7B0666C>
- [5] Министерство за образование и наука на Република Македонија (2004) *Национална илтерогба за развој на образованието во Република Македонија (2005 - 2015)*.
- [6] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија (2013) *Стратегија за родова еднаквост (2013-2020)*.
- [7] Општини Радовиш и Конче (2007) *Стратешки илан за 2007 – 2011 г.*
- [8] Поповски, С. (2010) *Квалитетот на високошко образование иод илрашање – дисертација како образовен феномен*. Скопје, Фондација Институт отворено општество Македонија, стр. 1-44.
- [9] Службен весник на Република Македонија бр. 10/2008 и 88/2008. *Оиши колективен договор за јавношко сектор на Република Македонија*.
- [10] Службен весник на Република Македонија бр. 149/2009. *Стратегија за регионален развој на Република Македонија 2009-2019 година*.
- [11] Службен весник на Република Македонија бр. 103/2010. *Уредба за нормативи и стандарди за основање високообразовни усшанови и за вршење високообразовна дејност*.

- [12] Службен весник на Република Македонија бр. 138/2014. *Страјтежија за изменување и дојолнување на страјтежијата за регионален развој на Република Македонија 2009-2019 година.*
- [13] Универзитет „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје, Комисија за евалуација (2011) *Извештај за самоевалуацијата на Универзитетот „Св. Кирил и Методиј“ во Скопје (за периодот 2006/07-2009/10).*
- [14] Хаџи - Зафирова, Ж. (2009). За дисперзирани студии требаат милиони. *Утрински весник*, 31 мај 2009. [на интернет] Достапно на: (<http://www.utrinski.mk/?ItemID=1F3AB794C1B5C5449A13D19E0DFC08BC>).
- [15] Центар за истражување и креирање политики (2009) *Како до јо̀квалиџетно високо образование?*
- [16] Angrist, J. and Lavy, V. (2002) New Evidence on Classroom Computers and Pupil Learning. *Economic Journal* 112(482): 735–786.
- [17] Brent, R. J. (2006) *Applied Cost -Benefit Analysis*, Second Edition. Northampton, Edward Elgar Publishing, p.1-493.
- [18] Devarajan, S., Squire, L. and Suthiwart-Narueput, S. (1997) Beyond Rate of Return: Reorienting Project Appraisal. *World Bank Research Observer* 12(1): 35-46.
- [19] Dunn, B.P. and Sullins, W.R. (1982) Cost-Benefit Analysis: Applicability in Higher Education. *Journal of Education Finance*, Vol. 8, No. 1, p. 20-32.
- [20] European Commission, Directorate-General for Regional and Urban policy (2014) *Guide to Cost-Benefit Analysis of Investment Projects (Economic appraisal tool for Cohesion Policy 2014-2020).*
- [21] Hough, J.R. (1993) Educational cost-benefit analysis. *Education Research Paper* No. 02, Loughborough University.
- [22] Jimenez, E. and Patrinos, H. A. (2008) Can Cost-Benefit Analysis Guide Education Policy in Developing Countries? The World Bank – Human Development Network. *Policy Research Working Paper* No. 4568, p. 1-45.
- [23] Magnusson, L. (1973) Cost-Benefit Analysis of Investment in Higher Education: Some Swedish Results. *The Swedish Journal of Economics*, Vol. 75, No. 2, p. 119-127.
- [24] McMahan, W. (2004) The Social and External Benefits of Education. *International Handbook on the Economics of Education*. Cheltenham: Edward Elgar, Cheltenham, p. 211-259.
- [25] McMahan, W. (2006) Education Finance Policy: Financing the Nonmarket and Social Benefits. *Journal of Educational Finance*, 32(2), p. 264-284.
- [26] Mincer, J. (1974) *Schooling, Experience and Earnings*. New York: Columbia University Press.
- [27] Perkins, D.R., Radelet, S. and Lindauer, D.L. (2006) *Economics of Development* (6th edition). New York: WW Norton.
- [28] Psacharopoulos, G. and Patrinos, H.A. (2004) Returns to investment in education: a further update. *Education Economics* 12(2), p. 111-134.
- [29] Renda, A., Schrefler, L., Luchetta, G. and Zavatta, R. (2003) *Assessing the Costs and Benefits of Regulation*. Study for the European Commission, Secretariat General. Brussels.
- [30] Wolfe B. and Haveman, R.H. (2002) *Social and nonmarket benefits from education in an advanced economy. Conference Series; [Proceedings]*, Federal Reserve Bank of Boston, vol. 47(Jun), p. 97-142.
- [31] Wolfe, B. and Zuvekas, S. (1997) Non-Market Effects of Education. *International Journal of Education Research* 27(6), p. 491-502.
- [32] Woodhall, M. (2004) *Cost-benefit Analysis in Educational Planning*. UNESCO, International Institute for Educational Planning, Paris.
- [33] Zerbo, R. O. Jr. and Bellas, A. S. (2006) *A Primer for A Primer for Benefit - Cost Analysis*. Northampton, MA, Edward Elgar Publishing, Inc.